



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. 5727/4 Prot.

Tiranë më 7.8. 2025

URDHËR

Nr. 986/L, datë 7.8. 2025

PËR

RISHIKIMIN E URDHËRIT NR.986, DATË 08.07.2025, “PËR HAPJEN E FAZËS SË APLIKIMEVE PËR KONKURRIM PËR NDJEKJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “SIGURIA DHE HETIMI”, CIKLI I PARË “BACHELOR”, NË AKADEMINË E SIGURISË, VITI AKADEMIK 2025–2026”

Në mbështetje të, në nenit 55, pika 2, shkronjat “c” dhe “l”, nenit 70, të Ligjit 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe nenit 144-146, të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”;

Me qëllim garantimin e parimit të shanseve të barabarta, meritokracisë dhe transparencës së procesit të konkurrimit, si dhe për të mundësuar trajtimin në kohë në mënyrë të drejtë dhe objektiv të ankesave të paraqitura;

URDHËROJ:

1. Rishikimin e urdhrit nr.986, datë 08.07.2025, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, viti akademik 2025–2026”.

2. Në Kreun e I-rë, pika dy e këtij urdhri periudha e fazës “Ankimimi” ndryshon dhe bëhet:

“Çdo aplikant ka të drejtën e ankimimit pas çdo faze të konkurrimit, brenda dy diteve nga momenti i njohjes me rezultatin e testimit ose skualifikimin e tij nga procesi në adresën e e-mail-it burimet.njerezore@asp.gov.al, ose fizikisht në sekretarinë e Drejtorisë së Burimeve Njerezore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

3. Në Kreun e VI-të, pika gjashtë e këtij urdhri, ndryshon dhe bëhet:

“ Komisioni i Apelimit të shqyrtojë të gjitha ankesat e paraqitura në kohë sa më të shpejtë, me qëllim që aplikantët që kualifikohen pas shqyrtimit të ankesës të arrijnë fazat e tjera të konkurrimit. Komisioni Apelimit duhet të bazohet në të dhënat e komisioneve të vlerësimit, dokumentacionin përkatës, kriteret e përcaktuara në shpallje, si dhe të garantojë se vlerësimi i ankesave do të bëhet në mënyrë të barabartë dhe objektive, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ankuesit i kthehet përgjigje me e-mail brenda ditës nga marrja e vendimit të KA ”.

4. Akademia e Sigurisë të marrë masa për njoftimin e aplikantëve lidhur me procedurat e ankimimit.
5. Ngarkohet më zbatimin e këtij urdhri Komisioni i Apelimit, Akademia e Sigurisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
6. Për kontrollin e zbatimit të këtij urdhri, ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Drejtues Madhor Ilir PRODA

